

GJYKATA E QARKUT NË PEJË

KA.nr.40/11

Datë: 01 Mars 2011

Gjyqtari i EULEX-it për konfirmim Vladimir Kanev, në rastin penal kundër

ATDHE BEKAJ, i biri i Bajram Bekaj dhe nënës Rushe e gjinisë Ahmetaj, i lindur më 26 prill 1979, në Pejë, shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës.

I akuzuar sipas aktakuzës PPS.nr.109/10 të datës 25 Janar 2011, parashtruar në gjykatë më 04 Shkurt 2011, për vepër penale *Vrasje e Rëndë*, nga Neni 147 pika 9 të KPK-së.

Pas seancës për konfirmim të aktakuzës të mbajtur më 01 Mars 2011, në përputhje me Nenet 313 dhe 314 të KPPK-së, në praninë e Prokurorit Publik, të pandehurit dhe avokateve të tij mbrojtës Aziz Rexha, Haxhi Cekaj dhe Gafurr Elshani, dhe në përputhje me Nenin 316 par. 4 të KPPK-së, si në vijim lëshon këtë

AKTVENDIM

KONFIRMOHET aktakuza e Zyrës së Prokurorisë Speciale, PPS.nr.109/10 e datës 25 Janar 2011.

Aktakuza bashkë me të gjitha dokumentet e dosjes do të dërgohen Kryetarit të Trupit Gjykses për shqyrtimin kryesor, menjëherë pasi që ky aktvendim të marr formën e tij të prerë.

Arsyetimi

Historia Procedurale

Më 04 shkurt 2011, Zyra e Prokurorisë Speciale ka ngritur aktakuzën PPS.nr.109/10 kundër të pandehurit Atdhe Bekaj, duke e akuzuar atë për vepër penale të *Vrasjes së Rëndë* në bazë të Nenit 147 pika 9 të KPK-së, në lidhje me vrasjen e Sadik Musaj më 31 janar 2005.

Pasi që është ngritur aktakuza, gjyqtari për konfirmim, pas vlerësimit të saj në bazë të Nenit 306 par. 2 të KPPK-së, konstaton se aktakuza është përpiluar në përputhje me Nenin 305 të KPPK-së.

Gjyqtari për konfirmim ka caktuar seancën e konfirmimit më 1 mars 2011, për të cilën janë thirrur; Prokurori Publik, i pandehuri Atdhe Bekaj, avokati i tij mbrojtës Haxhi

Cekaj. Gjithashtu pala e dëmtuar Sami Musaj ishte ftuar që të marrë pjesë në seancë. Seanca ishte e hapur për publikun.

Pasi që Prokurori Publik e lexoi aktakuzën dhe pasi që gjyqtari u siguroi se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të pandehurit ju ofrua mundësia të deklarohet si fajtor apo i pafajshëm.

I pandehuri Atdhe Bekaj u deklarua i pafajshëm.

Në paraqitjen e tyre, avokatët mbrojtës kundërshtuan kualifikimin e veprës penale, në mënyrë specifike në lidhje me motivin dhe qëllimin. Për më tepër, ata kundërshtuan në përgjithësi lidhur me procedurën e dëshmimeve gjatë fazës së procedurës paraprake dhe në lidhje me dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët okular.

I pandehuri mbështeti paraqitjen e mbrojtësit të tij.

Konstatimet e Gjykatës

Neni 316 par. 1 të KPPK-së përcakton se aktakuza mund të hidhët poshtë nëse vepra me të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale, apo ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale, apo ka kaluar afati i parashkrimit, apo ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen dhe nëse nuk ka prova të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën me të cilën akuzohet.

Gjyqtari konstaton se asnjëra nga rrethanat më lartë nuk mund të aplikohen në procedurën aktuale. Faktikisht, sipas dosjes së rastit dhe dëshmimeve që përbejnë, ka prova të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e bazuar.

Sipas dosjes së rastit, rezulton se dëshmitari okular i cili kishte qenë duke ecur bashkë me viktimën kur është sulmuar viktima, ka identifikuar sulmuesin të ketë qenë i pandehuri Atdhe Bekaj. Dëshmitari ka deklaruar se i pandehuri Atdhe Bekaj, ka qëlluar në drejtim të Sadik Musaj, përderisa ky i fundit ishte duke ecur bashkë me dëshmitarin në rrugë.

Dëshmitari ishte duke shoqëruar të pandehurin Atdhe Bekaj – duke e ndihmuar atë të ndez motorin e makinës. Në një moment, i pandehuri u drejtua drejt një dyqani të auto pjesëve, përderisa dëshmitari qëndroi në veturë duke pritur. Pas vetëm dy minutave, dëshmitari dëgjoi të shtënat me armë. Ai vërejti se i pandehuri kishte revole në dorë- dhe se viktima po e mbante atë për dore.

Të dy dëshmitarët kanë deklaruar se ata ishin në dijeni për marrëdhëniet e këqija në mes të pandehurit dhe viktimës, kryesisht për shkak të dëshmisë së të ndjerit në gjykimin kundër “Grupit të Dukagjinit.”

Kur i pandehuri u arrestua më 21 tetor 2010, revolja – “Browning” – ishte gjetur në posedimin e tij. Kjo revole u dërgua në laborator për tu ekzaminuar. Raporti i Ekspertizës

nga Laboratori i Forenzikës nr. 2010-2448, të datës 6 janar 2011, ka vërtetuar se të katër gëzhojat dhe dy plumbat të kalibrit 9mm të gjetura në vendin e krimin dhe një plumb i nxjerr nga trupi i viktimës, kanë të njëjtat karakteristika me revolen e të pandehurit.


Prandaj, bazuar në rrethanat që janë ofruar në aktakuzë, gjyqtari për konfirmim konstaton se ekzistojnë prova të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale me të cilën akuzohet, dhe në këtë mënyrë konfirmon aktakuzën.

Në fund, vlen të përmendet se të gjitha dëshmitë të siguruara gjatë hetimeve janë të pranueshme dhe në këtë mënyrë nuk ka nevojë të deklarohet ndonjë provë specifike si e papranueshme.

Të gjitha çështjet në lidhje se sa relevante janë dëshmitë dhe të cilat duhet të vlerësohen përkundrejt aktakuzës, do të jenë temë e shqyrtimit gjatë shqyrtimit kryesor.

Prandaj është vendosur sikur në dispozitivin e këtij aktvendimi, në përputhje me Nenin 316 par. 4 të KPPK-së.

GJYKATA E QARKUT NË PEJË, KA.nr.40/11, më 01 Mars 2011.



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk mund të paraqitet ankesë.